KONGRESI SHKENCOR I FSHMT 2026

Integrimi i kujdesit paliativ në sistemin shëndetësor publik në Shqipëri: domosdoshmëri përballë plakjes së popullsisë dhe rritjes së sëmundjeve kronike

Autorët: Irena Laska, Prof. Dr Alma Barbullushi, Gledisa Karanxha

Afilacionet: Qendra e Kujdesit Paliativ “Mary Potter”; QSUNT; ONYX Health Education

Autori prezantues: Irena Laska

Hyrje: Plakja e popullsisë dhe rritja e barrës së sëmundjeve kronike, progresive dhe kërcënuese për jetën shtojnë nevojën për kujdes të vazhdueshëm dhe gjithëpërfshirës. Megjithëse legjislacioni shqiptar parashikon ofrimin e kujdesit paliativ edhe në kujdesin shëndetësor parësor, përvoja praktike sugjeron një hendek ndërmjet parashikimeve ligjore dhe aksesit në shërbime. Qëllimi është të shqyrtohet nevoja për integrim në sistemin publik dhe roli i edukimit profesional e advokacisë.

Metodat: Analizë narrative dhe përshkruese, e mbështetur në kuadrin ligjor për kujdesin paliativ dhe në përvojën e Qendrës së Kujdesit Paliativ “Mary Potter” në Korçë, përfshirë zhvillimin e shërbimeve, aktivitetet e dokumentuara të trajnimit gjatë viteve 2020–2026 dhe bashkëpunimin me kujdesin shëndetësor parësor. Nuk është kryer vlerësim i ndikimit të trajnimeve në rezultatet klinike.

Rezultatet: Gjatë viteve 2020–2026, qendra ka trajnuar 2,084 profesionistë shëndetësorë në të gjitha qarqet e Shqipërisë, kryesisht infermierë, në kujdesin paliativ bazë, menaxhimin e simptomave, përdorimin e opioideve dhe kujdesin në banesë. Ky tregues dokumenton shtrirjen e aktivitetit edukues, jo ndryshime të matura në aksesin apo cilësinë e kujdesit. Përvoja e qendrës identifikon si sfida njohjen e vonshme të nevojave për kujdes paliativ, koordinimin e kufizuar ndërmjet niveleve të kujdesit dhe aksesin e pamjaftueshëm për pacientët me sëmundje jo malinje. Kujdesi parësor ka rol të rëndësishëm në identifikimin e hershëm te pacientëve në nevojë, mbështetjen e familjes dhe referimin.

Përfundime: Integrimi i kujdesit paliativ kërkon fuqizimin e kujdesit shëndetësor parësor, edukim të vazhdueshëm, bashkëpunim ndërinstitucional dhe advokaci për zbatimin e legjislacionit. **Kujdesi paliativ nuk duhet të jetë privilegj i pacientëve me diagnoza të caktuara apo i atyre që jetojnë pranë shërbimeve të specializuara, por pjesë e kujdesit shëndetësor të aksesueshëm për të gjithë pacientët që kanë nevojë për të.**

Fjalë kyçe: Kujdesi paliativ; kujdesi shëndetësor parësor; integrimi i shërbimeve; plakja e popullsisë; sëmundjet kronike.

Seksioni i propozuar: T8 – Politika, Etikë dhe Sisteme Shëndetësore

Preferenca e prezantimit: Prezantim me gojë